



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2024:095334

Datë: 30.05.2024

Numri i dokumentit: 05759907

C.nr.1069/2024

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Leotrim Gashi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit S.Z, me vendbanim në F.K, Rruga "N.V", të cilin e përfaqëson i autorizuari K.F, avokat me seli në P, kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria e Arsimit me seli në Vushtrri, të cilën e përfaqëson Ismet Gashi, me objekt kontesti kompensim për ushqim-shujta, për ditët e pranisë në punë, me vlerë të objektit të kontestit 418.00 euro, jashtë seance, më datë 30.05.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit S.Z dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, që paditësit, në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit-shujtave për ditët e pranisë në punë për 209 ditë pune dhe atë për periudhën kohore nga data 01.01.2022 e deri me datë 22.11.2022, t'ia kompensoj shumën në vlerë prej 418.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke e llogaritur nga data e paraqitjes së padisë me datë 13.03.2024, e deri në pagesën definitive, në afat prej shtatë (7) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. **DETYROHET** e paditura Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, që paditësit S.Z, në emër të shpenzimeve të procedurës, t'ia paguaj shumën në vlerë prej 124.00 euro, në afat prej shtatë (7) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësi me datë 13.03.2024, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, ka ushtruar padi në këtë gjykatë kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria e Arsimit, me objekt kontesti për kompensim të ushqimit-shujtave për ditët e pranisë në punë.

Pretendimet e palëve

Paditësi përmes padisë, ka kërkuar që gjykata ta detyroj të paditurën që duke u bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit, nr.105 e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021 (Tani e tutje KKA) t'ia paguaj atij shpenzimet e ushqimit-shujtave për ditët e pranisë në punë, në shumën prej dy (2) euro në ditë për periudhën kohore nga data 01.01.2022 e deri me datë 22.11.2022 dhe atë për 209 ditë pune, në shumën e përgjithshme prej 418.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% në vit,

duke e llogaritur nga data e paraqitjes së padisë me datë 13.03.2024, e deri në pagesën definitive, në afat prej shtatë (7) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Përmes përgjigjes në padi së të autorizuarit të së paditurës Ismet Gashi, të datës 23.05.2024, e paditura ka kërkuar që gjykata ta refuzoj kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të pabazuar me arsyetimin se të paditurës i mungon legjitimacioni pasiv për të qenë palë në këtë procedurë kontestimore sepse ajo nuk ka qenë pjesëmarrëse në marrëdhëniet detyimore siç përcaktohet me nenin 8.1 të LMD-së e as nuk ka marrë obligime për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga KKA-ja siç përcaktohet me nenin 245 të LMD-së, por që këtë e kanë bërë Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) e të cilat nuk kanë përmbushur obligimet e kësaj Kontrate, për të siguruar mjete buxhetore për Komunitet.

Ndërsa sa i përket shpenzimeve të procedurës ka theksuar që të njëjtat i bartë Paditësi.

Provat

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike sipas propozimit të palëve ka vlerësuar dhe administruar këto prova: Kontrata e punës e lidhur në mes paditësit dhe të paditurës si dhe Vërtetimi i datës 26.05.2023, i lëshuar nga Shkolla Filllore e Mesme Ulët “Gjergj Kastriot Skënderbeu”, në Pantinë-Vushtrri, për ditët e punës së paditësit.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë dhe kërkesëpadisë, provave të propozuara si dhe përgjigjes në padi në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së, ka çmuar me kujdes dhe me ndërgjegje çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Në mes palëve nuk ishte kontestues fakti se paditësi kanë qenë në marrëdhënie pune tek e paditura për gjatë kësaj periudhe për të cilën e ka kërkuar kompensimin. Po ashtu nuk ishin kontestuese as ditët e pranisë në punë nga paditësi, këto të vërtetuara edhe nga vërtetimi për ditët e punës, të cilave gjykata ia fali besimin e plotë duke u bazuar edhe në nenin 329.1, të LPK-së, në të cilin përcaktohet që “*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e atij që konfirmohet apo caktohet në të*”, pasi është lëshuar nga institucionet arsimore të së paditurës.

Kontestuese në mes palëve ishte fakti nëse pala e paditur ka legjitimitet pasiv në këtë çështje kontestimore. Pra në këtë procedurë për gjykatën ishte e rëndësishme që të vërtetohet baza ligjore lidhur me kërkesëpadinë e paditësit dhe besueshmërinë e saj me prova e po ashtu edhe pretendimet e palës së paditur se ajo nuk ka legjitimitet për të qenë palë në këtë procedurë.

Sa i përket bazueshmerisë kërkesëpadisë së paditësit, e njëjta rrjedh nga neni 35.7 i KKA-së ku parashihet se *“Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqime gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro, për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restorantit, kuzhinës ose në një formë tjetër, nuk ka obligim pagese, të të punësuarve për ushqim.”*, prandaj gjykata ka vendosur që ta aprovoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, si në dispozitivin I të këtij aktgjykimi sepse ai i ka provuar ditët e punës siç është përcaktuar me kërkesëpadi.

Konkretisht sipas Vërtetimit të datës 26.05.2023, i lëshuar nga Shkolla Filllore e Mesme Ulët “Gjergj Kastriot Skënderbeu”, në Pantinë-Vushtrri për ditët e punës së paditësit, ai gjatë periudhës kohore nga data 01.01.2022 e deri me datë 22.11.2022, ka pasur 209 ditë të pranisë në punë dhe në bazë të një kalkulimi të 209 ditëve të punës, shumëzuar për vlerën prej dy (2) euro në ditë për shujtën ditore, rezulton se detyrimi i të paditurës ndaj paditësit në emër të kompensimit për shujtën ditore është në shumën prej 418.00 euro.

Detyrimi i të paditurës ndaj paditësit është e përcaktuar edhe me nenin 8.1 të Ligjit nr 04/l-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), është përcaktuar që *“Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit”*, kurse me nenin 245 të LMD-së është paraparë që *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, e që në këtë rast e paditura është e detyruar që të përmbushë një detyrim ndaj paditësit, ashtu siç është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në anën tjetër për gjykatën nuk mund të qëndroj pretendimi i të paditurës se pasi që e paditura nuk ka qenë nënshkruese e Kontratës Kolektive, asaj i mungon legjitimiteti pasiv në këtë çështje. Kjo ngase në radhë të parë e paditura është punëdhënësi i paditësit dhe të njëjtit janë në një raport kontraktual të marrëdhënies së punës e po ashtu faktit se KKA-ja është e lidhur në nivel vendi, me efekt të zbatueshëm në të gjithë Republikën e Kosovës. Lidhur me këtë, me nenin 90, par 2.1 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, është paraparë që *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në nivel të vendit”* dhe mbi këtë bazë kërkesëpadija e paditësit është e bazuar në Kontratën Kolektive nr. 105, e datës 22.01.2021, të lidhura në mes Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) në njërin anë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) në anën tjetër.

Për më tepër me dispozitën e nenit 2.1.1 të KKA-së nr. 105, është përcaktuar që *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla special e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”*, kurse me pikën 1.2 të këtij neni të thuhet se *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e arsimit (komunal - DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo – arsimore*

private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”, e që nënkupton që e paditura detyrohet të përmbushë obligimet e saja që rrjedhin nga KKA-ja ndaj paditësit.

Gjykata përveç kërkesës kryesore, duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 par.2 të LMD-së dhe Mendimin juridik për kamatën i Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 265/2020 i datës 02.12.2020 paditësit i’ a njohu edhe të drejtën në kamatë ligjore, në lartësi prej 8% në vit, duke llogaritur nga data 13.03.2024, si dita e paraqitjes së padisë në këtë gjykatë e deri në pagesën definitive.

Lidhur me shpenzimet e procedurës si në dispozitivin II të këtij aktgjykimi, gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 449 të LPK-së e po ashtu nenit 452.1, të LPK-së sipas të cilit përcaktohet që *“Pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtare gjyqësore dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t’ia shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore”*, ashtu e paditura duhet që paditësit të ia paguaj shpenzimet e procedurës dhe atë për përpilimin e padisë shumë prej 104.00 euro dhe në emër të taksës gjyqësore në shumë prej 20.00 euro, në shumë të përgjithshme prej 124.00 euro.

Gjykata vendosi që këtë çështje kontestimore ta vendos jashtë seancës gjyqësore ashtu siç është përcaktuar me nenin 398 të LPK-së, e cila parasheh që: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ai, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, ngase thënie e paditësit lidhur me gjendjen faktike në padi për ditët e punës u vërtetuan me provat e propozuara nga ai, të cilat prova janë lëshuar nga institucionet arsimore të së paditurës, që nuk janë kontestuar as nga pala e paditur dhe në këtë mënyrë e bënë të themeltë edhe kërkesëpadinë e paditësit. Kurse fakti se e paditura e ka kontestuar kërkesëpadinë mbi bazën e legjitimitetit pasiv, nuk është pengesë për të marrë aktgjykim jashtë seance sepse ashtu siç u theksua më lartë, ky kundërshtim është prezumim ligjor e jo rreth gjendjes faktike, e i cili është i pabazuar.

Gjykata ka vlerësuar se marrja e aktgjykimit pa mbajtur seancë gjyqësore është në harmoni edhe me praktikën e ndërtuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), e cila praktikë është obligim që të zbatohet nga Institucionet e Republikës së Kosovës. Kjo duke u bazuar në nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ku thuhet se *“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*.

Në rastin [Jussilia kundër Finlandës](#), nr.73053/01, pika 41, GJEDNJ ka konstatuar se mund të ketë procedura gjyqësore në të cilat mund të mos mbahet një seancë dëgjimore, siç mund të jenë rastet kur nuk janë kontestuese çështjet e besueshmërisë ose fakteve dhe gjykatat mund të vendosin çështjen në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme vetëm në bazë të parashtrësive të palëve dhe materialeve tjera të shkruara, e po ashtu në rastin [Saccasia kundër Austrisë](#), nr.69917/01, pika 76, është konstatuar nga GJEDNJ se mos mbajtja e seancës gjyqësore mund të justifikohet në rastet që ngrenë apo kontestohen thjesht çështje ligjore të një natyre të kufizuar.

Prandaj, duke u bazuar në nenin 398 të LPK-së dhe praktikën e GJEDNJ-së, përderisa e paditura në kundërshtimet e saj me përgjigje në padi ka kontestuar vetëm çështje materiale-ligjore, siç

konsiderohet legjitimiteti i palëve, sipas vlerësimit të gjykatës mbajtja e seancave gjyqësore është e panevojshme, ndërsa vendosja lidhur me çështjen si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ka mundur të realizohet mjaftueshëm edhe jashtë seance vetëm përmes shkresave të lëndës.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2024:095334, C.nr.1069/2024, me datë 30.05.2024**

G j y q t a r i

Leotrim Gashi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditësh, pas ditës së pranimi të të njëjtit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.